



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS LIDHUR ME VIZITËN NË QENDRËN E PARABURGIMIT NË MITROVICË

Për:

- Z. Abelard Tahiri, Ministër**
Ministria e Drejtësisë

- Z. Uran Ismaili, Ministër**
Ministria e Shëndetësisë

- Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm**
Shërbimi Korrektues i Kosovës

- Z. Milazim Gjocaj, Drejtor i Përgjithshëm për Shëndetësi në Burgje**
Ministria e Shëndetësisë

- Z. Benasim Mediç (origj: Benasim Mediç), Drejtor**
Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë

Prishtinë, më 28 qershor 2019

HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë.

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejme *MKPT*) i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 12 mars 2019, vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme *QPM*).

Qëllimi i kësaj vizite ishte shqyrtimi i respektimit të të drejtave të njeriut për të burgosurit e vendosur në QPM, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Në QPM pranohen të paraburgosurit dhe të dënuarit me dënime nën 20 vjet. Të burgosurit janë të nacionaliteteve të ndryshme dhe janë të vendosur në dy kate.¹ Sipas Drejtorisë së QPM-së, kapacitetit i kësaj qendre është për 77 persona. Në kohën kur MKPT-ja e vizitoi QPM-së, ishin të akomoduar 10 të paraburgosur dhe 37 të dënuar.

Gjatë vizitës u trajtua edhe çështja e procedurave të pranimit, njohja e të burgosurve me të drejtat e tyre, trajtimi, kushtet e vendosjes, regjimi, kujdesi shëndetësor, raportet ndërmjet të burgosurve, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore, të cilat mund t'u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), si dhe mënyra e ekzekutimit të tyre.

Përbërja e grupit monitorues

1. Ekipi monitorues përbëhej si në vijim:

- Zëvendësja e Avokatit të Popullit
- Drejtoresha e MKPT-së
- Këshilltari i lartë juridik për parandalim të torturës
- Këshilltarja juridike për parandalim të torturës
- Këshilltarja-mjeke
- Këshilltarja-psikologe
- Këshilltarja-punëtore sociale.

¹ Të dhëna nga ueb-faqja zyrtare e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në: <https://shkk.rks-gov.net/institucionet-single/2236>.

Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës që MKPT-ja i bëri QPM-së, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (në tekstin e mëtejshëm *DShB*), i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe, në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, e përdori fotoaparatin pa u penguar fare nga autoritetet e QPM-së.

Keqtrajtimi fizik

3. Gjatë vizitës në QPM, MKPT-ja nuk mori ankesa për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. MKPT-ja vërejti se niveli i komunikimit interaktiv ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të të burgosurve është në nivel të kënaqshëm.

Ankesë kundër mënyrës së zbatimit të kontrollit trupor

4. Megjithatë, MKPT-ja vërejti se Avokati i Popullit, më 21 mars 2019, pranoi ankesën e të burgosurit I.M., i cili ankohet kundër veprimeve të zyrtarit korrektues me rastin e kontrollit trupor të ushtruar ndaj tij më 20 mars 2019. Sipas pohimeve të ankuesit, zyrtarët korrektues kanë kërkuar nga ai që të zhvishej komplet në banjë, në prani të 4-5 oficerëve dhe të dy personave të tjerë, të cilët janë të vendosur në të njëjtën qeli. I burgosuri pohoi se për të ishte veçanërisht e pakëndshme dhe poshtëruese situata gjatë kontrollit të trupit, kur nga ai është kërkuar që të ulej, të kollitej dhe të lëvizte majtas dhe djathtas.²
5. MKPT-ja konsideron se të gjitha kontrollet e tilla duhet të bëhen ekskluzivisht në pajtim me nenin 35, paragrafi 1, të LESP-së, i cili shprehimisht përcakton: "*Personi i dënuar nuk duhet të kontrollohet në mënyrën e cila e cenon dinjitetin e tij. Shkalla e bezdisjes së personit të dënuar gjatë kontrollimit duhet të jetë proporcionale me qëllimin e tij, ashtu siç është paraparë me këtë nen.*"
6. Më tej, neni 35, paragrafi 6, i LESP-së përcakton se kontrolli i trupit të zhveshur të të burgosurit bëhet prej dy punonjësve korrektues të së njëjtës gjini me atë të personit të dënuar dhe në një vend të veçantë, pa praninë e personave të tjerë, asnjëherë nuk bëhet në praninë e personave të gjinisë tjetër nga ajo e personit të dënuar, nuk përfshin zhveshjen e pjesëve të sipërme dhe të poshtme të trupit të personit të dënuar në të njëjtën kohë.³
7. Përveç LESP-së, edhe aktet juridike ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve përcaktojnë obligimin e autoriteteve kompetente që gjatë kontrolleve të tilla ta respektojnë dinjitetin e të burgosurit.⁴

Kushtet e akomodimit

8. LESP-ja shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë në strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.⁵ Më tej, ligji

² Rast i hapur për hetime nga Institucioni i Avokatit të Popullit, A.nr. 233/2019.

³ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, paragrafët 6.1, 6.2, 6.3.

⁴ Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 15.4. Rregullat e Mandelës, Rregullat 50, 51, 52.

⁵ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 1.

përcakton: “Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar, duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme, ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, si dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë, lexim, ngrohje dhe ajrosje.”⁶ Për më shumë, ky ligj përcakton se lokalet nuk duhet të kenë lagështi, duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.⁷

9. MKPT-ja vëren se, në përgjithësi, kushtet e akomodimit në QPM janë në pajtim me LESP-në, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe me Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm *KPT*).
10. Megjithatë, në një pjesë të QPM-së, në disa qeli, vërehen dëmtime të dysHEMEVE. MKPT-ja konsideron se autoritetet relevante duhet të ndërmarrin veprime për t’i evituar këto mangësi.

Ushqimi

11. LESP-ja përcakton se i dënuari ka të drejtë për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij me tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t’i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, për aq sa është e mundur, duhet t’i përshtatet kërkesave të tij fetare dhe kulturore. Më tej, ligji përcakton obligimin që të dënuarit t’i sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.⁸ Po ashtu, LESP-ja përcakton të drejtën e të burgosurit që gjatë gjithë kohës të ketë në dispozicion ujë të pijshëm.⁹
12. Rregullat e Mandelës, që është një akt i rëndësishëm juridik ndërkombëtar për të drejtat e të burgosurve, përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t’u sigurojnë ushqim adekuat për shëndetin e tyre, si dhe ujë të pijshëm gjatë gjithë kohës.¹⁰ Në këtë drejtim, Rregullat Evropiane të Burgjeve po ashtu përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t’u sigurojnë ushqim dietal, duke pasur parasysh moshën e tyre, gjendjen e tyre fizike, religjionin dhe natyrën e punës së tyre. Ndërsa ushqimi duhet të përgatitet dhe të shërbehet në kushte adekuate higjienike, kurse uji i pijshëm duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës.¹¹ MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit lidhur me këto të drejta.

Regjimi

13. Sa i përket regjimit, në QPM rreth 13 të dënuar janë të angazhuar në punë. Në kuadër të QPM-së funksionojnë pesë punëtori, në të cilat të dënuarit mund të angazhohen në punë

⁶ Ligji nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 3, paragrafi 2.

⁷ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 36, paragrafi 3.

⁸ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, paragrafët 1 dhe 2.

⁹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 40.

¹⁰ Rregullat e Mandelës, Rregulli 22.

¹¹ Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregullat 22.1 deri 22.6.

dhe në trajnime të ndryshme. Të dënuarit kanë të drejtë në së paku 2 orë shëtitje në ditë.¹² Në dispozicion të të burgosurve janë edhe biblioteka, shëtitoret dhe salla e fitnesit.

14. Përveç angazhimeve në punëtori, në punë pastrimi dhe në kuzhinë, gjatë kësaj periudhe në QPM u organizua edhe trajnimi për kontroll të agresivitetit, në të cilin u angazhuan 19 të burgosur. Ky trajnim u mbështet nga organizata joqeveritare HELP. MKPT-ja ka vërejtur se QPM-ja është pajisur mirë me hapësira për organizim të kurseve. Ndërsa në rastin e të paraburgosurve, angazhimi në punë dhe në aktivitetet tjera është subjekt i lejes nga gjykata kompetente.

Kujdesi shëndetësor

15. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.¹³
16. Personeli mjekësor i QPM-së përbëhet prej katër infermierëve të rregullt, të cilët punojnë me ndërrime, mjeku i përgjithshëm, i cili punon me normë të plotë dhe i cili është në dispozicion edhe për thirrje telefonike, ndërsa psikiatri punon me gjysmë norme.
17. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua se momentalisht nuk ka psikolog. Më herët, përmes një organizate joqeveritare ishte angazhuar një psikologe, por kjo OJQ tani nuk zhvillon veprimtari në QPM. Lidhur me këtë, MKPT pas vizitës kontaktoi me drejtorin e DShB i cili e njoftoi se procedurat për rekrutim të psikologut të rregullt kanë përfunduar dhe se nga data 1 korrik do të fillojë punën kandidati i përzgjedhur. MKPT mirëpret këtë zhvillim në QPM.
18. Sa i përket infrastrukturës, njësia shëndetësore posedon dhomën ku kryhen vizitat mjekësore, intervenimet, si dhe trajtimet stomatologjike. MKPT-ja konsideron se kjo hapësirë nuk është adekuate për ofrim të shërbimeve mjekësore dhe nuk mbron konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore. Njësia shëndetësore posedon EKG-në, bombolë oksigjeni, defribilator, tensiometër, material shpenzues dhe shok-terapinë.
19. Shërbimet tjera mjekësore ofrohen nga qendra më e afërt e mjekësisë familjare dhe nga spitalet rajonale. Përveç kësaj, njësia shëndetësore i posedon të gjitha protokollat relevante mjekësore. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa sa i përket respektimit të së drejtës për kujdes adekuat shëndetësor.

Rëndësia e kontroleve mjekësore të të burgosurve të sapo pranuar

20. KPT-ja dhe aktet tjera juridike ndërkombëtare vazhdimisht theksojnë rëndësinë e kontrollimit mjekësor të të burgosurve të sapo pranuar, veçanërisht në institucionet të cilat përbëjnë pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një kontrollim i tillë është esencial,

¹² Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë për së paku dy orë shëtitje.

¹³ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 43, paragrafi 2.

veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).

21. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut mund të japin kontribut domethënës në parandalimin e keqtrajtimit fizik, gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë, në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.¹⁴
22. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale¹⁵ dhe Praktika Standarde e Veprimeve¹⁶ e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapo pranuar t'i nënshtrohet kontrollimit mjekësor brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit.
23. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës¹⁷, Rregullat Evropiane të Burgjeve¹⁸ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.¹⁹
24. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe dokumentacionin relevant mjekësor, të burgosurit e sapo pranuar kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh, nga momenti i arritjes në QPM.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

25. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit²⁰, e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale²¹, me standardet e KPT-së,²² si dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës²³ dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.²⁴
26. Për më shumë, edhe standardet e KPT-së po ashtu përcaktojnë se të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve duhet të kryhen ashtu që të mos shihen dhe të mos dëgjohen nga zyrtarët korrektues, përveç në rastet kur mjeku e kërkon një gjë të tillë.

¹⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

¹⁵ Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

¹⁶ Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

¹⁷ Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

¹⁸ Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

¹⁹ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

²⁰ Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

²¹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

²² Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

²³ Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf.

²⁴ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf.

27. Po ashtu, neni 25, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, shprehimisht përcakton: “*Mjeku bënë vizitën mjekësore në kushte të konfidencialitetit mjekësor dhe normave etike profesionale.*”
28. Bazuar në informatat nga stafi i shërbimit shëndetësor dhe në intervistat me të burgosurit, shërbimet shëndetësore, në përgjithësi, jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues.

Çështje të tjera

29. Gjatë vizitës në QPM, MKPT-ja ka pranuar shqetësimet e punëtorëve socialë (dy punëtorë socialë të angazhuar në QPM) rreth dokumentacionit zyrtar, i cili duhet t’u dorëzohet personave të privuar nga liria, të cilët janë të dy përkatësive etnike. Meqenëse dokumentacioni u vjen në një gjuhë, përkthimi zyrtar i tyre pa përkthyes profesional është i vështirë.
30. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet ta kenë parasysh obligimin ligjor që këto shërbime të ofrohen në gjuhët zyrtare të vendit, ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë dhe me legjislacionin relevant që e rregullon këtë çështje.

Masat disiplinore

31. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t’u shqiptohen të dënuarve janë: Qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.²⁵ Kurse në rastin e të paraburgosurve mund të shqiptohen dënime si në vijim: Kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike. Gjatë vizitës në QPM nuk pati të burgosur të ndëshkuar me masën disiplinore të vetmisë.
32. MKPT-ja u njoftua se shërbimi mjekësor nuk merr pjesë në marrjen e vendimit lidhur me aftësinë e të paraburgosurit apo të të dënuarit, për ta përballuar masën disiplinore të vetmisë. MKPT-ja konsideron se personeli mjekësor e ka të qartë rolin e tij në këtë aspekt. Pjesëmarrja e mjekut në vendimmarrje, i cili në fakt është mjeku i personit të paraburgosur apo të dënuar, do ta minonte raportin mjek-pacient, përveç nëse kjo masë ndërmerret për arsye mjekësore.²⁶
33. MKPT-ja në raportet e mëhershme ka shprehur shqetësimin për faktin se legjislacioni në fuqi²⁷ parasheh që, para se i burgosuri të vendoset në vetmi, drejtori i institucionit korrektues të kërkojë me shkrim mendimin e mjekut, i cili dëshmon se i dënuari është në gjendje të mirë shëndetësore fizike dhe psikike për t’iu nënshtuar masës disiplinore të vetmisë. MKPT-ja mirëpret heqjen e kësaj dispozite nga drafti i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili pritet të votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. MKPT-ja do të vazhdojë ta përcjellë situatën sa i përket shqyrtimit në Kuvend të draft-ligjit në fjalë.

²⁵ Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

²⁶ Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka kërkuar nga autoritetet relevante që të ndërpritet praktika që nga mjeku të kërkohej vërtetim se i paraburgosuri apo i dënuari është në gjendje për ta përballuar masën.

²⁷ Neni 107 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe neni 76 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

Kontakti me botën e jashtme

34. Legjislacioni në fuqi²⁸, në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat minimum një orë, si dhe për vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë thirrje telefonike.
35. Lidhur me thirrjet telefonike, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese²⁹ përcakton se i dënuari ka të drejtë për biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë minuta).
36. Të dënuarit në regjim themelor mund t'i lejohet një thirrje telefonike gjatë javës, e cila zgjat 15 (pesëmbëdhjetë minuta), ndërsa të dënuarve në regjim të avancuar mund t'u lejohen dy thirrje telefonike, të cilat zgjasin 15 (pesëmbëdhjetë minuta).
37. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita "*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*", bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Bazuar në intervistat me të paraburgosurit, del se atyre u mundësohen dy vizita në muaj, sipas lejes së gjykatës, dhe një vizitë shtesë nga Drejtoria, bazuar në kërkesën e parashtruar nga i paraburgosuri, në rrethana të caktuara.
38. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues ose të personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen MKPT-së së Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.
39. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që, me shkrim ose me gojë, të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo me zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai/ajo.³⁰ MKPT-ja nuk ka marrë ankesa sa i përket respektimit të të drejtave të lartpërmendura.

Hapësirat ku pranohen vizitat

40. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vizituar edhe hapësirat në QPM ku pranohen vizitat familjare. Kushtet në këto hapësira mbeten në nivel të kënaqshëm dhe nuk ka barriera të cilat do ta pengonin kontaktimin e drejtpërdrejtë ndërmjet familjarëve dhe të të burgosurit. Po ashtu,

²⁸ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

²⁹ Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

³⁰ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33, paragrafi 1.

dhoma ku kryhen vizitat e lira është në gjendje të mirë, përfshirë edhe tualetet dhe pajisjet tjera relevante.

Incidentet ndërmjet të të burgosurve

41. Sipas Drejtorisë, gjatë këtij viti ka pasur raste të rralla të incidenteve ndërmjet të të burgosurve, të cilat nuk ishin incidente serioze. MKPT-ja ka vërejtur se këto incidente janë evidentuar në formularë përkatës administrativë dhe mjekësorë.

Procedura e parashtrimit të ankesave

42. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut, apo brenda qendrës së paraburgimit ku vendosen dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.
43. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshinë edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministria e Drejtësisë.³¹
44. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QPM janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, kutitë e ankesave të vendosura nga DShB-ja dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP). Kutitë e ankesave të vendosura nga IAP-ja mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa sa i përket respektimit të kësaj të drejte.

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, i Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon

Ministrisë së Drejtësisë:


- 1. Të rinovohen dyshemetë e dëmtuara në qeli, sipas nevojës.**
- 2. Në QPM të sigurohet përkthimi profesional në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr.

³¹ Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: “Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.”

05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Më nderime,



Hilmi Jashari

Avokat i Popullit